



Znj. Irena Alimeri, mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Llogarive Kombëtare prej muajit Maj 2022 dhe mbështetur në Ligj nr.17 /2018 për statistikat zyrtare është anëtare e Bordit Drejtues të Institutit të Statistikave (INSTAT). Znj. Alimeri është diplomuar për Ekonomiks, në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, në vitin 1999. Studimet pasuniversitare në Studime Ekonomike Evropiane i ka përfunduar pranë të njëjtit Fakultet, në vitin 2008. Në vitin 2000, Znj. Alimeri u bë pjesë e INSTAT, fillimisht si specialiste në sektorin e Statistikave të Ndërmarrjeve dhe për një periudhë rreth 11 vjecare, ka ushtruar funksione drejtuese, fillimisht në Drejtorinë e Statistikave Ekonomike dhe më pas Drejtorinë e Llogarive Kombëtare. Gjatë karrierës së saj profesionale ka kryer një sërë kualifikimesh në institucione ndërkombëtare, si EUROSTAT, FMN, OECD dhe Institute homologe të Statistikave në fushën e prodhimit statistikor, analizës së të dhënave si dhe në menaxhimin e cilësisë statistikore.

Falë eksperiencës shumë vjeçare, Znj. Alimeri zotëron aftësi profesionale në kryerjen analizave të thelluara ekonomike, statistikore, menaxhimin e projekteve dhe ndërveprimin me aktorë të tjerë institucionalë të fushës.